REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

| Pranuar - Primljeno Më/Dana 01.07.2024 | | | |
|---|---|---|---|
| Nr.i organit Org.broj | Numri/Broj | Shtojcë Prilog | Vlera Vrednost |
| 01- | 110 | 05-923 | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë, në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, neni 40, paragrafi 40.2, pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 të Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare Nr.28/2008), neni 2 dhe 4 i Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, nenit 35, paragrafi 35.2, pika b të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 28.06.2024 miraton këtë:

# VENDIM

## për plotësim ndryshim të vendimit për aprovim për bartjen e mjeteve nga një projekt në projektet tjera në shumë prej 148.376,16 Euro

**Neni 1**

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për plotësim ndryshimin e Vendimit Nr.01-110/05-670, të datës 30.04.2024 për aprovimin për bartjen e mjeteve nga një projekt në projektet tjera në shumë prej 148.376,16 Euro.

**Neni 2**

Konform nenit 1 të këtij vendimi plotësohet, ndryshohet pika 2 e vendimit bazë, ku:

a) Ndërtimi i rrugëve me zhavor, kodi i projektit 53847 në shumën prej 88.376,16 Euro.
b) Ndërtimi i ujësjellësit në fshatrat: Ramjan, Novosellë, kodi i projketit 52800 në shumën prej 60.000,00 Euro, fshihen krejt nga vendimi bazë dhe plotësohet, ndryshohet me:

**Fondi burimor 10:**

- Kategoria ekonomike investime kapitale të ridestinohen mjetet mes projekteve, shuma 98,376.16 €.
- Programi Buxhet e financa (175 ), nënprogrami Buxhetimi (17533).

Nga projekti:

- Asfaltimi i rrugës Ballancë – Kravaricë, kodi i projektit 52686, shuma prej 98,376.16 €.

**Në projektet**:

- Ndërtimi i rrugëve me zhavor në Beguncë, Lubishtë, Buzovik, Remnik, Pozheran, Radivojc, Smirë, Podgorc, Gjylekar, kodi i projektit 53845, shuma prej 88,376.16 €.
- Ndërtimi i ujësjellësave Ramjan – Novosellë, kodi i projektit 52800, shuma prej 10.000.00 €.

**Fondi burimor 21**

- Kategoria ekonomike investime kapitale të ridestinohen mjetet mes projekteve, shuma 50,000.00 €.
- Programi Buxhet e financa, 175, nënprogrami Buxhetimi 17533.

**Nga projekti**: Asfaltimi i rrugës Ballancë – Kravaricë, kodi i projektit 52686, shuma prej 50,000,00 €.

**Në projektin**: Ndërtimi i ujësjellësve Ramjan – Novosellë, kodi i projektit 52800 shuma prej 50,000.00 €
Koment: Bartja e mjeteve prej projekteve është kërkuar për atë se, kanë mbetur mjetet gjatë proçesit të tenderimit, Ky projekt është i financuar tërësisht në vitin 2023 dhe ka mbetje të mjeteve në shumë prej 150.000.00 € - planifikim i tejkaluar i buxhetit (nga fondi burimor - 10 granti qeveritar shuma 100,000.00 € dhe nga fondi burimor 21 - të hyrat vetanake shuma 50,000.00 €, kërkojmë që mjetet e mbetura të rialokohen në projektet ekzistuese, sepse gjatë proçesit të tenderimit është rritë vlera e projekteve në krahasim me shumën e mjeteve të alokuara (planifikuara).

**Neni 3**

Të gjitha pjesët tjera të vendimit për aprovim për bartjen e mjeteve nga një projekt në projektet tjera në shumë prej 148.376,16 Euro mbeten në fuqi.

**Neni 4**

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Vitisë, Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.

**Neni 5**

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për Procedurat e Hartimi dhe Publikimi të Akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
KRYESUESI
Bekim Azizi

Vendimi u dorëzohet:
1. Zyrës së Kryetarit;
2. Drejtorisë për Financa;
3. MAPL-së; dhe
4. Arkivit.